



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INXHINIERIT HIDROTEKNIK
INXHINIERËT HIDROTEKNIKË

METODOLOGJIA PËR ÇAKTIMIN E TARIFAVE
PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA PERSONAT JURIDIK-FIZIK QË
KRYEJNË SHËRBIME
NË FUSHËN E VEPRIMTARISË SË INXHINIERISË HIDROTEKNIKE

I. Shpërblimi i personave juridik/fizik që kryejnë shërbime në fushën e veprimtarisë së inxhinierisë hidroteknike.

- a. Vleftha vëhet për një shërbim që kryhet nga një person juridik/fizik i cili më herët është pajisur me të drejtën e ushtrimit të profesionit dhe certifikuar për atë shërbim.
- b. Personi juridik/fizik ka të drejtë të vendosë dhe të përfitojë tarifën në vlerë sipas procedurës së parashikuar në këtë akt.
- c. Qëllimi i përcaktimit të tarifave të shërbimeve në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës, të personave juridik/fizik është përfitimi i shërbimeve efektive dhe cilësore të ofruara dhe minimalisht të vlerësuara.

II. Parime për përcaktimin e vlefhtës së shërbimit.

- a. Shpërblimi i një personi juridik/fizike përbëhet nga një vlefte minimale referuese, që përfshin punët në “Studime dhe Preventiv Paraprak”, të “Projektim dhe Preventiv Përfundimtar. Vleftha bazë e shërbimit të personave juridik/fizike përcaktohet si përqindje, e vlerës së investimit të punimeve të veprimtarisë së inxhinierisë hidroteknike.
- b. Shpërblimi i një personi juridik/fizike përbëhet nga një vlefte minimale referuese, që përfshin punën në “Menaxhimin e Projekteve”, në “Mbikëqyrjes dhe Kolaudit”, në “Vlerësimit dhe Ekspertizës Teknike”. Për këtë shërbim është përcaktuar vleftha bazë fikse për dy ve ndodhje brenda në qytet dhe jashtë qytetit.
- c. Grupimi në tabela nuk përfshin të gjitha llojet e shërbimeve të fushës së inxhinierisë hidroteknike, për punët e pavlerësuar shpërblimi llogaritet me orë pune.

III. Shpenzimet sipas Legjislacionit në fuqi dhe veçanërisht të legjislacionit tatimor të Republikës së Shqipërisë.

- a. Të gjitha shpenzimet që janë të domosdoshme për të realizuar shërbimet janë të pasqyruara në këto vleftha.

- b. Tabelat e mëposhtme janë vetëm për shërbimin e kryer të inxhinierisë Hidroteknike, si edhe llogaritet për atë vleftë investimi që zënë vetëm punimet e fushës së veprimtarisë Hidroteknike.
- c. Vlefta minimale referencë e shërbimeve janë **pa TVSH**.
- d. Në çdo fazë të shërbimeve personi juridik/fizik, blen informacion nga Inxhinieri apo persona të tjerë të fushave të tjera, për të cilën është domosdoshmëri për të plotësuar shërbimin e plotë këto kosto nuk janë të përfshira në këto vlefta.
- e. Për përgatitjen e dokumentacioneve që nuk janë pjesë e projekti personi juridike/fizike mund të kërkojë deri në 10% të vleftës së studim-projektimit ose mund të përlllogarisë vleftën e shërbimit në kohë sipas vleftës së punëve të pavlerësuar.
- f. Për efekt të llogaritjes së kohës së punës, koha e transportit llogaritet vetëm në vajtje, d.m.th. koha e vajtjes për të kryer shërbimin në teren përlllogaritet si ore pune.

IV. Personat që duhet të paguajnë vleftën e shërbimit.

- a. Të gjithë personat juridike apo individë që do të marrin shërbime në fushën e veprimtarisë së inxhinierisë hidroteknike, janë të detyruar ti referohen këtyre vlerave minimale.
- b. Palët në marrëdhënien kontraktore mund të vendosin vlefta edhe më të larta se këto referuese, por asnjëherë më poshtë se këto vlefta.

V. Mbledhja e Vleftës së Shërbimit.

- a. Çdo person juridik/fizike i cili ushtron të drejtën e shërbimeve në fushën e veprimtarisë së inxhinierisë hidroteknike është i detyruar të lëshojë Faturën Tatimore të Shitjes.

VI. Deklarimi dhe Auditimi i tarifave të shërbimit

- a. Administratorët e personave juridik/fizike, janë të detyruar të deklarojnë vleftën e shërbimit dhe llojin e kontratës.
- b. Auditimi i vleftës bëhet nga institucioni i urdhrit profesional hidroteknik dhe regjistrohet në regjistrin përkatës. Auditimit ka për qëllim vetëm shmangien e evazionit fiskal, si edhe detyrimeve të këtij ligji.

VII. Grupimet dhe fazat e shërbimeve

- a. Grupimi është bërë sipas ndarjes së shërbimeve të natyrës së njëjtë dhe vlerës që kanë në sektorët përkatës ku gjen zbatim inxhinieria hidroteknike.

- 1) Gr. I. Burimet Ujore'
- 2) Gr. II. Furnizimi me Ujë, Ujërat e Zeza dhe Drenazhimi Urban'
- 3) Gr. III. Përmbytjet dhe Menaxhimi i Rrezeqeve'
- 4) Gr. IV. Energjia dhe Ndryshimet Klimatike'
- 5) Gr. V. Përmirësime Ujore'
- 6) Gr. VI. Projektet Konstruktive'

b. Tabelat janë ndarë si me poshtë;

- 1) Formula 1; “Studim dhe Preventiv Paraprak”, si edhe “Projektim dhe Preventiv Përfundimtar”,
- 2) Vlera për Menaxhimin e Projekteve, për Mbikëqyrjes dhe Kolauditimit.
- 3) Vlerësimin dhe Ekspertizës Teknike.
- 4) Vlera për punime të pavlerësuar,

c. Vleftha në tabelë është në milion lekë.

d. Shënime;

- i. Për llogaritjen e vlerës së shërbimit të Fazës së Studimit-Projektimit, vlera e ndërtimit d.m.th. investimit merret vlera e preventivit paraprak sipas vetë studimit. Për efekte të lidhjes së kontratës së shërbimit bëhet një vlerësim i përafërt dhe në fund të shërbimit bëhet korrigjimi i vlefthës së shërbimit. Në përfundim të projektit të zbatimit dhe hartimit të preventivit përfundimtar bëhet korrigjimi i vlefthës së shërbimit.

VIII. Tarifat në përqindje (%) të investimit

- 1) **Faza që** përfshin vlerën hartimit të dokumentit bazë, që është studimi i thelluar dhe hartimit të preventivit paraprak të projektit (Studimin e Fisibilitetit), si edhe për Projektimin dhe Preventivin Përfundimtar.

Metodika për përllogaritjen e vlerës së shërbimit

“Për Studimin dhe Preventivin Paraprak, si edhe për Projektimin dhe Preventivin Përfundimtar”

Tabela 1.

Nr.	Milijon leke	F. V. Hidroteknike ne (%) REFERENCA E LLOG.	Perllogaritja nga grafiku EKSPONENCIAL ne %
1	1	20	23.262
2	10	15	11.958
3	20	10	9.787
4	50	8	7.510
5	100	6	6.147
6	300	4	4.475
7	mbi 300	3% e l mbi 300 + (V e 300)	3% e l mbi 300 + (V e 300)

Këto llogaritje janë të mbështetura me këto të dhëna referuese dhe është ndërtuar me formulën Eksponenciale, si mëposhtme që do të zbatohet;

FORMUALA 1

$$Y = 1260.8 * X^{-0.289}$$

X - vlera e investimit
Y - përqindja e llogaritjes së vlerës së shërbimit

- Kjo është formula që do të aplikohet për të llogaritur vlerën e shërbimit "Për Studimin dhe Preventivin Paraprak", si edhe për Projektimin dhe Preventivin Përfundimtar" kundrejt vlerës së investimit.
- Për vlerën e investimit mbi 300 milion merret vlera e plotë e 300 milionëshit dhe pjesa mbi do të merret fikse me 3% të investimit.
- Kjo është përqindja e plotë e të gjithë vlerës së shërbimit kundrejt preventivit paraprak, siç shikohet, kemi dy faza shërbimi që realisht do të zgjaten në kohe, për efekt të ndarjes do të pranojmë që faza e parë e Studimit do të vlerësohet me 40% të vlerës dhe projekti i zbatimit me 60% të vlerës.

2) Faza që përfshin Menaxhimin e Projektit (ndërtimi në terren) dhe Mbikëqyrjen

Vlefëta e shërbimit të inxhinierit hidroteknik që punon në menaxhim të projekteve dhe me mbikëqyrje është pasqyruar mëposhtme. Kjo vlerë përfshin koston totale minimale referencë të shërbimit.

a) Shërbimi Jashtë Qytetit 1 orë 6000 lekë

Vlerësimi i mësipërm tregon që një (njësi) inxhinier hidroteknik që do të punojë jashtë qytetit do të paguhet minimalisht 6000 lekë/orë.

b) Shërbimi brenda Qytetit 1 orë 4000 lekë

Vlerësimi i mësipërm tregon që një (njësi) inxhinier hidroteknik që do të punojë brenda në qytetit do të paguhet minimalisht 4000 lekë/orë.

Shënim:

Për efekt të pagesës së shërbimit llogaritjet nuk mund të bëhen më shumë se 8 orë në ditë, si edhe jo më shumë se 22 ditë në muaj. Për efekt të mirë kuptimit me kontraktuesin, orët e punës së dite do të ndahen 75 % në terren dhe 25 % në zyrë.

Për vlerën e mbikëqyrjes ashtu edhe të menaxhimit mund të behet parashikim i vlerës së kontratës kundrejt zbërthimit të grafikut të punimeve.

Këto shërbime përfshijnë menaxhimin dhe mbikëqyrjen, me qëllim administrimin e dokumentacionit, ligjor, teknik, financiar, (Kontabilitetin e Plotë).

3) Faza që përfshin kolaudimin e të gjithë projektit.

Për shërbimin e Kolaudimit të Projektit aplikohet vlera fikse e shërbimit, që do të jetë 10 % e vlerës përkatëse të "Studim-Projektimit" S-P.

4) Faza që përfshin Vlerësimin dhe Ekspertizën Teknike.

Për Vlerësimin dhe Ekspertizën Teknike gjatë fazës së ndërtimit do të merret vlefë e plotë e përlllogaritur në % dhe do të jetë minimalisht 20% e vlerës përkatëse të "Studim-Projektimit".

Kurse për ngjarjen si gjatë ndërtimit edhe gjatë shfrytëzimit do të merret vlefë në përqindje e kapitalit të dëmtuar pa ndarje, në vlerën 1 % e demit.

Duke qenë se Vlerësimi dhe Rivlerësimi është i detyrueshëm të bëhet në disa faza, atëherë vlefë e shërbimit ndahet në % të Vleftës së S-P dhe çmimi do të ndahet në tre pjesë, si mëposhtë;

- | | | |
|---------|---|-------|
| 1) F 1. | Studim dhe Preventivi Paraprak | 30 %, |
| 2) F 2. | Projektimi dhe Preventivi Përfundimtarë | 40 %, |
| 3) F 3. | Gjatë Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrjes | 30 % |

IX. Vlefë për punët e pavlerësuar.

Për shërbimet e inxhinierisë hidroteknike për punët që gjenden të pavlerësuar shpërblimi llogaritet me orë pune. Vlefë minimale referencë e shërbimit është pa TVSH.

- 1) Për 1 deri në 8 orë në ditë.

Vlefë minimale është	1 orë	4000 lekë
----------------------	-------	-----------

- 2) Për më shumë se një ditë si edhe jo më shumë se 22 ditë në muaj.

Për efekt të pagesës së shpërblimit llogaritjet nuk mund të bëhen më shumë se 8 orë në ditë, si edhe jo më shumë se 22 ditë në muaj. Për efekt të mirë kuptimit me kontraktuesin, orët e punës së dite do të ndahen 75 % në terren dhe 25 % në zyrë, për ato punë që kërkojnë domosdoshmërinë e vajtjes në teren.

Urdhri profesional hidroteknik përcakton objektin e shërbimit, detyrën, kohën e punës, si edhe formatin e aktit të punës së kryer.

Shembull 1:

Për përcaktimin e kostos së shërbimeve në fushën e disiplinës së hidroteknike për të gjitha fazat e projektit.

- A. Vlera e preventivit të ndërtimit hidroteknike është rivlerësuar paraprakisht investimi prej 200,000,000 leke, pa TVSH.
- B. Projekti ndodhet jashtë qytetit dhe koha e ndërtimit është përlogaritur për 300 ditë pune.
- C. Menaxheri i projekti do të punojë mesatarisht 5 ore pune/ ditë, kurse mbikëqyrësi rreth 3 ore në ditë.
- D. Objekti është i grupit të III, Përmbytja dhe Menaxhimi i Rreziqeve.

- ❖ Referuar skemës së menaxhimit të shërbimeve të disiplinës së hidroteknike do të llogaritim çmimin e shërbimit për këtë projekt që është Për Përmbytjen dhe Menaxhimin e Rrezikut të segmentin e lumit.

1) Faza që përfshinë shërbimin Për Studimin dhe Preventivin Paraprak , si edhe për Projektimin dhe Preventivin Përfundimtar.

Në referencë FORMULA (1), Për vlera të preventivit paraprak prej 200,000,000 leke, me ndihmën e kësaj formule gjejmë % për të cilën do të përlogarisim vlerën e shërbimit

FORMULA 1

$$Y = 1260.8 * X^{-0.289}$$

X - vlera e investimit

Y - përqindja e llogaritjes së vlerës së shërbimit

$$5.031 \% (200,000,000) = 10,061,866 \text{ leke}$$

për efekt të ndarjes do të pranojmë që faza e parë e *Studimit të vlerësohet me 40%* të vlerës dhe *projekti i zbatimit me 60%* të vlerës.

✚ Kosto e Shërbimit për hartimin e Studimit dhe P.P. (40%) është $0.4 * 10,061,866 = 4,024,746$ leke

✚ Kosto e Shërbimit për përgatitjen e projekti të zbatimit dhe P.P. (60%) është $0.6 * 10,061,866 = 6,037,120$ leke

Pas preventivit përfundimtar bëhet korrektimi i vlerës së shërbimit.

2. Faza që përfshin Vlerësimin dhe Ekspertizën Teknike.

Për Vlerësimin dhe Ekspertizën Teknike gjatë fazës së ndërtimit do të merret vlefë e plotë e përlogaritur në % të investimit dhe do të jetë minimalisht 20% e vlerës përkatëse të "Studim-Projektimit".

Vlera e Shërbimit S-P $10,061,866 \text{ leke} * 0.2 (20\%) = 2,012,373 \text{ leke}$

✚ Ekspertiza 1.

Studim dhe Preventivi Paraprak (30 %) $2,012,373 * 0.3 = 603,712 \text{ leke}$

✚ Ekspertiza 2.

Projektimi dhe Preventivi Përfundimtarë (40 %) $2,012,373 * 0.4 = 804,949 \text{ leke}$

✚ Ekspertiza 3.

Gjatë Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrjes (30 %) $2,012,373 * 0.3 = 603,712 \text{ leke}$

3. Faza që përfshin Menaxhimin e Projektit (ndërtimi në terren) dhe Mbikëqyrjen .

a) Menaxheri i projekti do të punojë mesatarisht 5 ore pune/ ditë. Projekti është përlogaritur të përfundojë për 300 ditë pune.

$300 \text{ ditë pune} * 5 \text{ ore në ditë} = 1500 \text{ ore pune.}$

$1 \text{ ore pune jashtë qyteti } 6000 \text{ leke}$

$1500 \text{ ore pune} * 6000 \text{ leke} = 9\,000\,000 \text{ leke}$

✚ **Menaxheri i Projektit** do të përfitojë minimalisht për punën e kryer të tij për të gjithë projektin vlerën 9 000 000 leke pa TVSH

b) Mbikëqyrësi do të punojë mesatarisht rreth 3 ore në ditë.

$300 \text{ dite pune} * 3 \text{ ore në ditë} = 900 \text{ ore pune.}$

1 ore pune jashtë qyteti 6000 leke

$900 \text{ ore pune} * 6000 \text{ leke} = 5\,400\,000 \text{ leke}$

🚧 **Mbikëqyrësi** i projektit do të përfitojë minimalisht për punën e kryer të tij për të gjithë projektin vlerën 5 400 000 leke pa TVSH

4. Faza që përfshin Kolaudimin e veprës.

Për shërbimin e Kolaudimit të Projektit aplikohet vlera fikse e shërbimit, që do të jetë 10 % e vlerës përkatëse të "Studim-Projektimit".

Vlera e Shërbimit S-P $10,061,866 \text{ leke} * 0.1 \text{ (10\%)} = 1,006,187 \text{ leke}$

🚧 Kolaudatori i projektit do të përfitojë shpërblimin për punën e kryer të tij vlerën 1,006,187 leke pa TVSH